



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Shkurt 2022

Nr: 43

**VENDIM**

**PËR**

**LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARËVE TË KZAZ NR. 2, QARKU**  
**SHKODËR, SEKRETARIT TË KZAZ NR. 2, QARKU**  
**SHKODËR DHE SEKRETARIT TË KZAZ NR. 4, QARKU SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, si më poshtë:

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 472 prot., datë 3.2.2022, ka kërkuar lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ nr. 2, qarku Shkodër, lirim dhe emërim të sekretarit të KZAZ nr. 2, qarku Shkodër dhe të sekretarit të KZAZ nr. 4, qarku Shkodër.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 29, pika 1, shkronja “c”, 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



## VENDOSI:

1. Të lirojë nga detyra anëtarin e KZAZ nr. 2, qarku Shkodër, z. Ersen Spahija dhe të emërojë z. Erzen Tokaj.
2. Të lirojë sekretaren e KZAZ nr. 2, qarku Shkodër, zj. Sabina Danaj dhe të emërojë sekretare zj. Arlina Kruja.
3. Të lirojë nga detyra sekretarin e KZAZ nr. 4, qarku Shkodër, z. Arlind Sylja dhe të emërojë sekretare zj. Sabina Danaj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

